

**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
*REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA*  
**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
OSNOVNI SUD PRIŠTINA – BASIC COURT OF PRISTINA

---

**PKR.nr.486/15**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA** – në trupin gjykues të përberë nga gjyqtarja Shadije Gërguri- kryetare e trupit gjykues, gjyqtarëve Beqir Kalludra dhe Lutfi Shala si anëtarë të trupit gjykues, me bashkëpunëtorin profesional Driton Berisha, në lëndën penale kundër të akuzuarëve H.Sh. dhe V.Sh. për shkak të veprës penale të kryer në bashkëkryerje Falsifikim i parasë nga neni 302 par 2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë PP1.nr 287/2015, të dt 28.08.2015, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësorë, në të cilën kanë marrë pjesë prokurorja Bukurije Gjonbalaj, të akuzuarit H.Sh. dhe V.Sh. me dt: 16.08.2018, mori dhe publikisht shpalli:

**A K T G J Y K I M**

**TË AKUZUARIT:**

**H.SH.**, nga i ati M., e ëma Xh., e vajzërisë S., i lindur me dt. ... në P.1, me vendbanim në rr."P.2" pa nr., në P.1, ka të kryer shkollën e mesme, pronar i restorantit "Sh." në P.1, i martuar, baba i ... fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

**V.Sh.**, nga i ati N., e ëma M., e gjinisë Z., i lindur me dt...., në P.1, ku dhe tani jeton, në rr.P.2', pa nr., në P.1, ka të kryer shkollën e mesme, tani student në fakultetin Ekonomik, i amrtuar, puntor me nxjëmje, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

**JANË FAJTOR**

**SEPSE;** me datë 23.01.2015, në rrugën "I.K.", në P.1, të pandehurit H. e V.Sh. kanë vënë në qarkullim kartëmonedhën në vlerë prej 50 (pesëdhjetë) euro të falsifikuar, me numër serik S20175422632, në atë mënyrë që sipas marrëveshjes paraprake duke e ditë se ai apo en është i falsifikuar, kanë vënë në lajthim shitësin ambulant të cigareve A.A., të cilit i pandehuri V. pasi ka marrë nga i pandehuri H. këtë apo enë ka tentuar të blejë një pako me cigare dhe meqë shitësi ka dyshuar se paratë janë false, ka refuzuar që t'ua shes cigarete, por nga afërsia patralla e policisë e cila ka vëzhguar ngjarjen dhe veprimet e të pandehurve, përkatësisht të pandehurin H. që po e priste të pandehurin Valmir, i kanë nxënë në flagrancë e më pas ua kanë sekuestruar kartëmonedhën e dyshuar e cila pas ekzaminimit nga Sektori

për Ekseprtimit të dokumenteve dhe dorëshkrimeve, ka rezultuar se është totalisht e falsifikuar,-

- me çka kanë kryer veprën penale falsifikim i parasë nga neni 302 par.2 lidhur me nenin 31 të KPK-së.

Andaj gjykata në kuptim të neneve; 2,7,8,9,17,21,31,41,42,49,50,51,52,62,73,75,76 të KPRK-së dhe neneve 365 dhe 450 të KPPK-se e:

Të akuzuarit **H.Sh.** i shqiptoi DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej **1 (një) viti** i cili dënim nuk do të ezzekutohet, nëse i njëjti nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale në periudhë kohore prej **2 (dy) viteve**.

Të akuzuarit **V.Sh.** për veprën penale falsifikim i parasë nga neni 302 par.2 lidhur me nenin 31 të KPK-së i shqiptoi DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej **6 (gjashtë) muaj** i cili dënim nuk do të ezzekutohet, nese i njëjti nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale në periudhë kohore prej **1 (një) viti**.

Konform nenit 302 par.6 të KPRK-së konfiskohet kartmonedha prej 50 € (pesëdhjetë) eurove me numër serik S20175422632 dhe e njehta duhet të asgjësohet pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Të akuzuarit H.Sh. dhe V.Sh., obligohen të paguajnë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë të kësaj gjykate, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej **50€ (pesëdhjetë) euro, secili veç e veç** në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi.

### **Arsyetim**

Prokuroria Themelore në Prishtinë PP1.nr 287/2015, të dt 28.08.2015, ika akuzuar H.Sh. dhe V.Sh. për shkak të veprës penale të kryer në bashkëkryerje Falsifikim i parasë nga neni 302 par. 2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së,-së duke propozuar që të njejtit të shpallen fajtor dhe të dënohen sipas ligjit.

Në këtë çështje penale gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestar në të cilën të akuzuarit H.Sh. dhe V.Sh. pasi që janë njoftuar me të drejtat e tyre në kuptim të nenit 323 par.1 dhe 2 të KPPRK-së, janë deklaruar të pafajshëm lidhur me veprën penale Falsifikim i parasë nga neni 302 par 2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së. Meqenëse të njëjtit nuk e kanë pranuar fajësinë lidhur me këtë vepër penale, gjykata duke u bazuar në nenin 327 të KPPRK-së, ka vendosur që seanca e shqyrtimit gjyqësor të vazhdojë me fjalën hyrëse dhe prezantimin e provave.

Prokurorja e shtetit Bukurije Gjonbalaj në fjalën përfundimtare ka deklaruar se pas administrimit të provave, siç janë aktvendimi i sekuestrimit të kartmonedhës i dt: 23.01.2015, raporti i ekspertizës nga sektori për ekspertim të dokumentave dhe dorëshkrimeve i dt: 30.03.2015, raporti i oficerit i dt: 23.02.2015 si dhe nga fotodokumentacioni që gjendet në shkresat e lëndës në mënyrë të qartë dhe bindëse, është vërtetuar se H.Sh. dhe V.Sh. kanë kryer veprën penale ashtu siç është përshkruar në dispozitiv të aktakuzës.

I akuzuari H.Sh. në mbrojtjen e paraqitur në shqyrtim gjyqësor ka deklaruar se në ditën kritike derisa ka qenë në komunë bashkë me të akuzuarin V. për menjëherë një qertifikatë të

lindjes, të njëjtit i'a ka dhënë një kartëmonedhë prej 50 euro për të ja blerë një paqetë cigare dhe që të njëjtat t'i bëjë në shuma më të vogla, ndërsa qëndërkohë e ka thirrur në telefon tani i akuzuari V. dhe i ka treguar se shitësi i cigareve i ka thënë se parat janë falso dhe me atë rast i akuzuari ka kërkuar nga i njëjti që t'ia sjellë parat dhe për këtë t'a njoftojë policinë dhe pasi që tani i akuzuari V. ka ardhur në komunë me të njëjtin janë nisur për të dalur nga komuna dhe në hyrje të saj janë takuar me policë, të cilët i kanë dërguar në stacionin policor ku edhe kanë dhënë deklaratë. Më tutje ka shtuar se arsyeja pse e ka dërguar tani të akuzarin V., ka qenë se është dashur të bëjë një pagesë në komunë lidhur me një shërbim të kryer mirëpo që nga zyrtari i komunës i është thënë se shuma e parave për pagesë duhet të jetë në vlerë më të vogël dhe se nuk ka dashur të humb rendin e pritjes për shkak se ka qenë tollovi, ndërsa që pas ballafaqimit në deklaratën e dhënë në polici me dt.23.01.2015 ku kishte deklaruar se “me dt: 23 kam qenë me shoqe për me bërë kurorë në zyrën e ofiqarisë duke pritur në rend”, është përgjigjur se e vërtetë është që ka shkuar me nxjerrëqertifikatën e lindjes, dhe se ndoshta nuk e ka kuptuar mirë pyetjen. Po ashtu i akuzuari është ballafaquar me deklaratën e dhënë në polici me dt.23.01.2015, ku kishte deklaruar se “bankënotën e ke marr para 3 dite”, dhe me deklaratën në prokuror me dt: 28.05.2015 ku kishte deklaruar se “Unë mendoj se paranë e falsifikuar në lokalin tim e kanë lënë të njëjtën ditëdisa persona nga Shqipëria të cilët kanë drekuar në restorant”, është përgjigjur se nuk e dinë nuk i kujtohet. Në fjalën përfundimtare ka deklaruar se nuk e ndjen vetën fajtor dhe se nuk e ka ditur që paratë kanë qenë të falsifikuara sepse po ta dinte të njëjtat do ti paraqiste në polici.

I akuzuari V.Sh.nënë mbrojtjen e paraqitur në shqyrtim gjyqësor ka deklaruar se ditën kritike derisa ka qenë në Komunë me tani të akuzarin H. të cilin e ka djalë të axhes, i njëjti jaka dhënë njëkartmonedhë prej 50 euro për të blerë një paqetë cigare dhe për ti kthyer në shuma më të vogla që pastaj të bëjëpagesë në komunë dhe kur monedhen ja ka dorëzuar shitësit, i njëjti i ka thënë se parat janë falso dhe më pastaj është kthyer në komunë dhe parat jaka dorëzuar tani të akuzarit H., dhe se bashku janë nisur të dalin nga komuna ku kanë takuar me policët, janë dërguar në stacionin policor ku edhe ka dhënë deklaratë. Më tutjeështë ballafaquar me deklaratën e dhënë në polici me dt.23.01.2015, ku kishte deklaruar se “kur kemi dal nga kafeneja mi dha 50 euro që të shkoj dhe të ja blej një pako cigare”, është përgjigjur se e vërtetë është se paratë i janë dhënë derisa kanë qendru në kuvend komunal dhe se i përmbahet deklaratavë të dhëna në procedurën paraprake. Në fjalën përfundimtare ka deklaruar se se nuk e ndjen vetën fajtor, se ai vetëm ka kryer shërbimin e kërkuar nga tani i akuzuari H., të cilin e ka familjar e i ka kërkuar të blejë një pako cigare mirëpo nuk ka pasur njohuri se paratë të cilat i ka përdorur për të blerëcigarettejanë të falsifikuara. Andaj, ka kërkuar nga gjykata që të njëjtin ta lirojë nga akuza për veprën penale për të cilën akuzohet.

Gjykata pas vlerësimit të provave të proceduara një nga një dhe të gjithave së bashku ka vërtetuar gjendjen faktike të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit.

Lidhur me këtë çështje penale, gjykata ka proceduar dhe administruar të gjitha provat personale dhe materiale të propozuara nga palët në procedurë, lista e provave materiale mbi sekuestrimin e kartmonedhës me nr. 2015AF-0065 të dt; 23.01.2015,raporti i ekserptizës nga sektori për ekspertim të dokumenteve dhe dorëshkrimeve me numër AKF/2015-1233/2015-1043 i dt; 30.03.2015 dhe raporti i oficerit të dt; 23.02.2015, si dhe fotodokumentacioni dhe provat tjera të cilat gjenden në shkresa të lëndës.

Nga lista e provave materiale mbi sekuestrimin e kartmonedhës me nr. 2015AF-0065 të dt; 23.01.2015, vërtetohet se tani të akuzuarit H.Sh. i është konfiskuar kartmonedha në vlerës prej 50 euro me numër serik S20175422632 e që po ashtu është shoqëruar edhe me fotografi ku shihet kartmonedha në vlerë prej 50 euro.

Nga raporti i ekspertizës nga sektori për ekspertim të dokumenteve dhe dorëshkrimeve me numër AKF/2015-1233/2015-1043 i dt; 30.03.2015, vërtetohet se në të njëjtin është konstatuar se kartmonedha 50 euro me numër serik S20175422632 e përshkruar si dëshmia #1 është falsifikim i plotë.

Nga raporti i oficerit Hazir Sylja të dt; 23.02.2015, vërtetohet se me datë 23.01.2015 rreth orës 13:20 në rrugën “I.K.” në P.1, tani të akuzuarit H. dhe V. kanë tentuar të blejnë një pako cigare dhe për pagesë i kanë ofruar një monedhë letër me vlerë 50 euro me numër serik S20175422632 që dyshohet të jetë e falsifikuar dhe se i akuzuari H.Sh. ka pranuar se kartmonedha është e tij.

Gjykata ka vlerësuar lista e provave materiale mbi sekuestrimin e kartmonedhës me nr. 2015AF-0065 të dt; 23.01.2015, nga e cila ka vërtetuar bindshmë faktin se tani të akuzuarit H.Sh. i është sekuestruar kartmonedha 50 euro me numër serik S20175422632, e që kjo është në përputhje edhe me vetë deklarin e këtij të akuzuari se në momentin e sekuestrimit të kartmonedhës të njëjten e ka pasur te vendosur në xhepin e tij.

Gjykata po ashtu ka vlerësuar edhe raportin e ekspertizës nga sektori për ekspertim të dokumenteve dhe dorëshkrimeve me numër AKF/2015-1233/2015-1043 i dt; 30.03.2015, nga e cila po ashtu vërtetohet bindshëm fakti se kartmonedhen të cilën tani të akuzuarit kanë dashur ta hedhin në qarkullim , ka qenë kartmonedhë e falsifikuar.

Gjykata ka vlerësuar edhe raportin i oficerit H.S. të dt; 23.02.2015, nga e cila po ashtu ka vërtetuar bindshëm faktin se në momentin e sekuestrimit të kartmonedhës, tani të akuzuarit H. dhe V. kanë qenë se bashku, dhe se i akuzuari V. ka tentuar të blejë cigare me këtë kartmonedhë të falsifikuar, e që kjo po ashtu është në përputhje edhe me vetë pohimet e të akuzuarve, të cilët në deklaratën e dhënë në polici kanë pohuar se me këtë kartmonedhë kanë dashur të blejnë cigare.

Gjykata bazuar në të gjitha provat e administruara ka ardhur në përfundim se në veprimet inkriminuese të akuzuarve manifestohen të gjitha elementet e vepres penale falsifikim i paras nga neni 302 par.2 të KPPK-se, duke qenë se tani i akuzuari e ka ditur se kartmonedhat janë të falsifikuara dhe pikërisht duke qenë në dijeni të këtij fakti të njëjten e kanë vënë në qarkullim duke pretenduar se të njëjtat janë të vërteta, ashtu që sipas marrëveshjes paraprake dhe duke vepruar në bashkëkryerje dhe duke e ditur se kartmonedha është e falsifikuar dhe me qëllim që ta njëjten ta hedhin në qarkullim, kanë shkuar të shitësi ambulant i cigareve A.A., në rastin konkret i akuzuar V. dhe ka tentuar që më të njëjtin të blejnë një pako me cigare, mirëpo pasi që i njëjti ka dyshuar se paratë janë false, ka refuzuar që t’ua shes cigare, ndërsa që kartmonedha e falsifikuar është gjetur në posedim të tani të akuzuarit H.Sh. bashkë më të cilin ka qenë edhe tani i akuzuari V.Sh..

Gjykata ka vlerësuar edhe mbrojtjen e të akuzuarve H.Sh. dhe V.Sh., mirëpo të njëjten e ka gjetur të pabazuar dhe në funksion të ikjes nga përgjegjësia penale për veprën penale për kryerjen e të cilës janë akuzuar.

Sa i përket mbrojtjes së të akuzuarit H.Sh., e njëjta është e pabazuar dhe në vetë vetë kontradiktore me deklaratat që i njëjti ka dhënë në procedurë paraprake , gjegjësisht në polici me dt.25.01.2015 ashtu që ndryshe nga shqyrtimi gjyqësor ku ka deklaruar se në Komunë ka qenë me tani të akuzuarin V. për të marrur një certifikat të lindjes, dhe se paratë ka dhënë që të njëjtat të i bëjë të imta për të bërë një pagesë në Komunë. Në procedurën paraprake, gjegjësisht në deklaratën e dhënë në polici me dt.25.01.2015 ka deklaruar se kartmonedhen jaka dhën për të ja blerë një pako cigare, se ka qenë me të shoqen për tu bërë kuror në komunë dhe se aty afër ka pasur djalin e axhes tani të akuzuarin V., ndërsa që për këto kontradikta, nuk ka qenë në gjendje të jap shpjegime të arsyeshme, që do e perlignin këtë ndryshim në deklaratat lidhur me përshkrimin e rrethanave të njëjta, mirëpo që mbrojtja e tij në shqyrtim gjyqësor ka qenë në kundërshtim me deklaratimet e dhëna në procedurën paraprake edhe lidhur me rrethanën se si ka rritur të jetë në posedim të kartmonedhes false, ashtu që ka deklaruar se marrja e parave ka ndodhur para tri dite nga një klient, ndërkaq që nuk ka përmendur rrethanën e prenduar se kinëse tani i akuzuari V. e ka njoftuar në telefon se monedha është false. Më tutje, ky i akuzuar, në deklaratën në prokuror me dt.28.05.2015 ka bërë ndryshim në mbrojtjen e tij, ashtu që tani ka deklaruar se në Komunë ka shkuar për të marr një certifikat të lindjes, dhe ka qenë bashkë me tani të akuzuarin V., dhe paratë ja ka dhënë Valmir për të blerë një pako cigare pasi që nuk ka pasur para të imta, ndërsa që paratë e falsifikuar ja kanë lënë disa të Shqipërisë të cilat kanë drekuar atë ditë në restorantin e tij. Këto ndryshime të deklaratave të këtij të akuzuari, padhënë shpjegime të arsyeshme, por vetëm duke u mjaftuar me fjalët se “Pasha Zoti nashta nuk e kom kuptu pyetjen mirë, se nuk ju rrej...nuk më kujtohet”, e bëjnë qartësisht të pabesueshme dhe të rreme, mbrojtjen e të njëjtit.

Lidhur me mbrojtjen e të akuzuarit V.Sh., po ashtu e njëjta është e pabazuar duke qenë se është kontradiktore me vetë deklaratimet e këtij të akuzuarit të dhëna në procedurën paraprake , gjegjësisht deklaratës së dhënë në polici me dt.25.01.2015 ku kishte deklaruar se derisa ka dalur nga kafiteria, tani i akuzuari H. ja ka dhënë kartmonedhen prej 50 euro për të blerë cigare dhe nuk e ka përmendur rrethanën e pretenduar se e ka thirrur në telefon të akuzuarin Hazir, ndërsa që në deklaratën e dhënë në prokuror me dt.28.05.2015, ka pohuar ekzistencën e rrethanave se kinëse bashkë me të akuzuarin H. kanë shkuar në komunë për të marrur një dokument në zyrën e ofiqaris dhe se në momentin kur i është thënë nga shitëjsa se kartmonedha është e falsifikuar, e ka thirrur në telefon tani të akuzuarin H., dhe pasi që ka shkuar në Komunë, duke qenë se kanë qenë shumë njerëz duke pritur, kanë filluar të largohen. ky i akuzuar nuk ka qenë në gjendje të jep një përgjigje të arsyeshme për këtë ndryshim në deklaratimet e tij lidhur me rrethanat e njëjta, mirëpo vrehet qart se ky ndryshim në deklarim ngjajshmë si edhe me të akuzuarin H. është bërë pas deklaratës së dhënë në polici, dhe kjo me qëllim të bërjes së një alibie të ngjajshme lidhur me veprimet e të njëjtes të ditën kritike, ashtu që pasi që i akuzuari H. ka deklaruar se kanë qenë në Komunë, mirëpo sipas tij ka qenë më bashkëshorten e vetë dhe se i akuzuari V. vetëm ka qenë i pranishëm, i akuzuari Valmir në deklaratën e dhënë në prokuror ka deklaruar se në momentin kur i janë dhënë në hollat kanë qenë në Komunë, mirëpo përtej kësaj, i akuzuari Hazir nuk ka arritur të shpjegojë faktin se në deklaratën e dhënë në polici ka deklaruar se ka qenë me bashkëshorten, dhe me qëllim korurzimi, ndërkaq që edhe pas tentimit për deklarimit në mënyrë të ngjajshme, ka dallime thelbësore në deklarimet në mes tyre, ashtu që derisa i akuzuari Hazir thotë se kanë qenë për të marrur një certifikat të lindjes, i akuzuari V. deklaron se kanë qenë për të marrur një certifikat të ofiqaris. Përtej këtyre dallimeve, që të dy këta të akuzuar në

deklaratën e dhënë në polici, kanë deklaruar se i akuzuari H. ja ka dhënë kartëmonedhen prej 50 euro dhe i akuzuari V. e ka marr këtë kartmonedhë për të bler cigare, ndërsa që me vonë kanë pohuar se kinse paratja ka dhënë që të i bëjnë të imta, për të paguar një detyrim në Komunë, pra e gjithë referimi për qenien në komunë është një rrethan e paqenë të cilën e ka shpikur i akuzuari H., ndërsa që tek në deklaratën e dhënë në prokurori me dt.28.05.2015 kjo është pohuar edhe nga i akuzuari V., ndërsa që të njëjtit nuk kanë ofruar asnjë provë për të bërë të besueshme e lëre më te bindshme alibin e tyre, por qëjo vetëm e kanë bërë tërësisht të pabesueshme këtë alibi me kontradiktat e vazhdueshme në deklaratat e tyre të dhëna qoft në procedurë paraprake e po ashtu edhe në shqyrtimin gjyqësor, por po ashtu këto kontradikta vërtetojnë natyrën pozitivisht të rremë të të njëjtit.

Gjykata gjatë matjes së denimit të akuzuarve iu mori të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e denimit konform nenit 73 të KPRK –së , për të akuzuarit si rrethanë lehtësuese për të akuzuarit H.Sh. dhe V.Sh.ka marrur faktin se të njëjtit nuk kanë qenë të gjykuar më parë dhe se ndaj tyre tij nuk zhvillohet procedurë për ndonji veprë tjetër penale, kohën nga momenti i kryerjes së veprës penale, për të akuzuarin H.Sh. edhe faktin se i njëjtit është i martuar, baba i ... fëmijeve dhe mbajtës i vetëm i familjes, ndërsa që për të akuzuarin V.Sh. si rrethanë lehtësuese ka marrur rrethanat personale të tij siq janë moshën e tij në kohën e kryerjes së veprës penale, faktin që tani është një student, duke manifestuar kështu faktin se nuk është element i rrezikshëm për shoqërinë, ndërsa që rrethana rënduese nuk ka gjetur. Andaj, gjykata vlerëson se dënimet e shqiptuara janë në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarve, intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura, dhe në këtë mënyrë do të ndikojë në parandalimin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, do të bëjë rehabilitimin e të njëjtëve, si dhe do të përmbajë persona të tjerë nga kryerja e veprave penale, çka është edhe qëllimi i dënimit nga nenit 41 të KPRK-së.

Vendimi për konfiskim është marrur konform nenit 302 par.6 të KPRK-së.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata morri konform dispozitave të nenit 450 par.2 nën.par.2.6 të KPRK-së.

Nga se u cek ma lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
**DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA**  
**PRKR.nr.486/15, të dt:16.08.2018**

**Bashkëpunëtori profesional Kryetarja e trupit - gjyqtarja,**  
**Driton Berisha**

**Shadije Gërguri**

**KESHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 / ditë nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj Gjykate.